



**BASHKIA E TIRANËS  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.20, datë 23.07.2014

**PËR  
‘DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I TIRANËS  
PAPA FRANÇESKU, PAPA I 266-TË I KISHËS KATOLIKE’**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim Relacionin “Për dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës, Papa Françesku, Papa i 266-të i Kishës Katolike, si dhe mbështetur ne nenin 7, pika 2, nenin 8/VII, gërma “a” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar);

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë propozimin për dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës Papa Françesku, Papa i 266-të i Kishës Katolike me motivacionin:
  - *“Në nderim të veprimtarisë dhe përkushtimit që ka dëshmuar çdo ditë, për të respektuar dhe inkurajuar njerëzit e thjeshtë, pa ndasi fetare apo status social, nëpërmjet shembullit të jetës së tij dhe veprave në krye të Selisë së Shenjtë, si dhe përzgjedhjen për të vizituar dhe bekuar si kryeqytetin e parë të Europës, pikërisht Tiranën, Kryeqytetin e Shqipërisë, simbol i bashkëjetesës fetare , i një populli besimplotë dhe mirënjohes për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Selia e Shenjtë.”*
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ALDRIN DALIPI**